

**VENDIM**  
**Nr. 358, datë 24.4.2013**

**PËR MËNYRËN E PROKURIMIT TË MALLRAVE, PUNËVE E TË SHËRBIMEVE, NË KUADËR  
TË VEPRIMTARIVE TË CEREMONIALIT ZYRTAR<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.621, datë 1.11.2017)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të vendimit nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

*1. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të prokurojnë mallra, punë dhe shërbime, sipas përcaktimeve të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në kuadër të organizimit të veprimtarive të veçanta dhe të përditshme me karakter protokollar dhe ceremonial.*

2. Prokurimet për këtë kategori i nënshtrohen procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, sipas dispozitave të legjislacionit për prokurimin publik. Nëse vlera e përlogaritur për artikuj apo grup artikujsh, brenda një viti kalendarik, është nën kufirin e ulët monetar.

Kjo procedurë prokurimi nuk zhvillohet me mjete elektronike.

*3. Shfuqizuar.*

4. Ngarkohen Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

---

<sup>1</sup> VKM nr.358, datë 24.4.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.73, 12 maj 2013.  
VKM nr.621, datë 1.1.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.193, 7 nëntor 2017.